



**INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT
REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**PROGRAMI I KURRIKULËS ME ZGJEDHJE TË DETYRUAR PËR SHKOLLAT
E MESME TË GJUHËVE TË HUAJA**

FUSHA: GJUHË E HUAJ

LËNDA: GJUHË FRËNGE

KODI: 3.2.11.Zgj.(f)

**PROGRAMI I LËNDËS
GJUHË FRËNGE
PËR KLASËN E 11-të
NIVELI FILLESTAR**

Koordinatori: Erifili Hashorva

Redaktori: Gazmend Krasniqi

Përgjegjës sektori: Marita Hamza

TIRANË, KORRIK 2010

Në kuadrin e politikave plurilinguiste e plurikulturore mbarë evropiane kurrikula e shkollës së mesme gjuhëve të huaja si promotor merr një rëndësi të veçantë për interpretimin dhe zbatimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit mbarevropian. Mësimi i një gjuhe të tretë duke u bazuar tashmë në eksperiencën të mësimin të gjuhëve të huaja si dhe nivele të përcaktuara sipas kuadrit të Përgjithshëm Evropian të Referencave do të ndikojë në formimin e mëtejshëm shkencor, gjuhësor si dhe në formimin qytetar të nxënësve tanë.

Ajo do të ndihmojë në shkëmbimet kulturore midis vendeve, në zhvendosjet e udhëtimit për motive të ndryshme. Programi i klasës 11-të për fillestarë parashikon sensibilizimin dhe hyrjen në një gjuhë dhe kulturë të re, në mënyrë që nxënësi të mund të zbulojë, të krahasojë dhe të përvetësojë shkallë-shkallë njohuri gjuhësore e social-kulturore duke siguruar përveç mësimin të gjuhës edhe përfundimin e qëndrimeve dhe sjelljeve të caktuara që inkurajojnë zhvillimin e individualitetit të nxënës/it,-es respektimin e diversitetit kulturor dhe të normave të ndryshme morale e zakonore duke lehtësuar komunikimin dhe shkëmbimet gjuhësore në të ardhmen. Duke pasur parasysh se nxënësit e klasës 11-të, në fakt janë fillestarë të rritur që mbartin tashmë njohuri të shumta mbi botën ndonëse sipas përshkruesve të aftësive të Kuadrit të Përgjithshëm të Referencave ky program synon të realizojë nivelin A1+, nivelin hyrës ose atë të zbulimit,

Po kështu, interesat dhe tematikat e fillestarëve të rritur do të jenë të ndryshme, pasi shkalla e ndërgjegjësimin të tyre për domosdoshmërinë e mësimin të gjuhës së huaj është më e lartë. Ata e dinë se nëpërmjet përdorimit të gjuhës së huaj mund të studiojnë apo më vonë të punësohen në një vend të Komunitetit Evropian.

Zotërimi i mirë i gjuhës së huaj do t'i ndihmonte të zgjeronin dijet e tij në fusha të tjera. Kështu gjuha e huaj kthehet në një instrument për të mësuar që pasuron aftësitë konjitive. Përvetësimi i gjuhës së huaj do të ndihmonte jo vetëm pasurimin dhe lulëzimin e individualitetit të nxënës/it,-es por edhe ndërtimin e qëndrimeve dhe sjelljeve etike që i shërbejnë komunitetit dhe krijojnë një qytetar të ri.

Programi i klasës 11-të i gjuhës frënge për fillestarë ashtu sikundër edhe programet e tjera të gjuhëve të huaja ka karakter tematik dhe përmban funksione të komunikimit si dhe njohuri gramatikore. Ky program synon mësimin e gjuhës nëpërmjet integritetit të katër aftësive kyç (të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit, të shkruarit). Duke iu referuar kurrikulës kombëtare dhe udhëzimeve të Kuadrit të Përgjithshëm Evropian të Referencave temat duhet të përkojnë me interesat e nxënësve.

Kështu, përzgjidhen tema mbi familjen, jetën e përditshme, shkollën, udhëtimit, festat e traditat etj; për sa i përket akteve të komunikimit nxënës/i,-ja mendohet të përvetësojë disa njohuri bazë që i lejojnë të prezantohet dhe të prezantojë njerëzit rreth tij, të kërkojë informacion, pra të zgjidhë probleme të thjeshta dhe imediate të jetës së përditshme etj; në aspektin gramatikor nxënës/i,-ja mund të përvetësojë disa struktura të thjeshta që mundësojnë një komunikim të kufizuar por të saktë.

1. SYNIMI I LËNDËS

Programi i gjuhës frënge për nxënësit fillestarë të klasës 11-të të arsimit të mesëm synon arritjen e nivelit **A1+**, **pra nivelin hyrës ose të zbulimit** të Kuadrit të

përbashkët evropian të referencës për gjuhët në një vëllim orar prej 8 orësh. Në këtë fazë të formimit, qëllimi i gjuhës së huaj është të sensibilizojë nxënësit ndaj gjuhës dhe kulturës franceze si edhe të formojë tek ata kompetencat bazë të komunikimit të një përdoruesi fillestar në katër veprimtaritë gjuhësore .

Programi i gjuhës frënge për klasën e njëmbëdhjetë synon që nxënës/i,-ja:

- të ndërgjegjësohet për ndryshimet dhe kontrastet midis gjuhëve duke evidentuar ngjashmëritë dhe ndryshimet e sistemeve gjuhësore me atë të gjuhës amtare.
- të reflektojë mbi ndryshimet mes praktikave kulturore të vendeve frëngjishtfolëse, vendeve të tjera si dhe asaj amtare ;
- të zhvillojë aftësinë bazë komunikuese dhe përdorimin e njohurive të thjeshta për të plotësuar nevoja konkrete në situata të jetës së përditshme
- të nxitë bashkëveprimin përmes punës në grup duke kapërcyer kështu vështirësitë e një pune të pavarur individuale.

Zbatimi i parimeve gjuhësore të të mësuarit aktiv si dhe realizimit të ndërveprimit në orën e mësimit ndërmjet nxënësve dhe grupeve të nxënësve ndikon në realizimin e synimeve të procesit të mësimdhënies/nxënies.

2. OBJEKTIVA TË PËRGJITHSHME

Objektivat e përgjithshme të programit synojnë:

- të arrijë një formim gjuhësor bazë në mënyrë që nxënës/i,-ja të mund të komunikojë në situata shumë të thjeshta, për të përballuar probleme të jetës së përditshme;
- të edukojë nxënësin me dashuri dhe respekt për kulturën e vendit gjuhën e të cilit mëson si dhe me ndjenjën e solidaritetit, të tolerancës dhe bashkëpunimit nëpërmjet punës së grup;
- të nxisin nxënësin/nxënësen dhe mësuesin në pasqyrimin dhe mbrojtjen e vlerave kulturore kombëtare duke synuar ndërveprimin kulturor
- të zhvillojnë personalitetin e nxënësit duke nxitur tek ai të mësuarit aktiv e të pavarur, mendimin kritik dhe shpirtin krijues për të përgatitur një nxënës/e që mund ta kthejë gjuhën e huaj nga objekt në një instrument të të nxënësit.

3. OBJEKTIVA

Objektivat e programit të klasës 11-të për fillestarë do të zërthehen hollësisht sipas standardeve dhe aftësive gjuhësore si më poshtë:

a) Objektiva sipas standardit në komunikim dhe kulturë

Përshkrimi: Të gjithë nxënësit, në këtë nivel duhet të aftësohen të komunikojnë për tema të njohura, për të zgjidhur nevojat konkrete të jetës së përditshme si dhe të përvetësojnë përshëndetjet, urimet dhe formula të tjera të mirësjelljes me qëllim që të iniciohen në njohjen e shprehive të një kulture tjetër dhe në vendosjen e kontakteve sociale bazë.

Programi i gjuhës frënge për klasën 11-të fillestarë është strukturuar sipas një formati të ri i cili planifikon si më poshtë :

	Objektiva
Kultura dhe komunikimi.	<p>Në përfundim të klasës së 11-të, nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të vendosë një kontakt social bazë duke përdorur formulat e mirësjelljes, përshëndetjet, urimet etj; • të ndjekë, të kuptojë thelbin dhe detajet e një bisede; • të shpjegojë një problem të thjeshtë; • të bëjë dallim mes objekteve, veçorive dalluese dhe interpretimit të tyre, • të kërkojë dhe të japë një informacion minimal lidhur me situata dhe tema të njohura; • të përshkruajë pa shumë detaje monumente të artit, personalitete, ngjarje me rëndësi historike (p.sh: revolucioni francez dhe diviza e tij, kështjellat dhe monumentet kulturore të Francës etj); • të trajtojë bashkë me mësimin e gjuhës çështje që lidhen më përdorimin e saj si, • treguesit e marrëdhënieve shoqërore; • rregullat e mirësjelljes.
	Objektiva
Aktet dhe funksionet e Komunikimit	<p>Në përfundim të klasës së 11-të, nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të prezantojë veten dhe të tjerët; • të përdorë formulat bazë të mirësjelljes (të kërkojë ndjesë, leje, të falënderojë, të urojë thjesht etj.); • të kërkojë /të japë një informacioni shumë të thjeshtë mbi tema të njohura, si vendbanimin, njerëzit që e rrethojnë etj; • të përvetësojë dhe përdorë një repertor elementar fjalësh të izoluar dhe shprehjesh të lidhura me disa situata konkrete të përditshme; • të krahasojë madhësi, forma, cilësi, çmime etj; • të orientohet në kohë dhe në hapësirë; • të përshkruajë shkurt dhe thjesht njerëzit dhe mjediset që e rrethojnë; • të përdorë shifrat, datat, ngjyrat, format; • të shprehë thjesht pëlqim ose mospëlqim etj.

b) Objektiva sipas standardit të formimit gjuhësor

Përshkrimi: Kjo linjë aftëson nxënës/in,-en të prodhojë elementë gjuhësorë që i përkasin nivelit A1+. Të gjithë nxënësit arrijnë një formim gjuhësor që lejon një komunikim bazë, njohjen e strukturave gjuhësore elementare. Nxënësi/sja në këtë nivel mund të kuptojnë dhe të përdorin shprehje të njohura dhe të përditshme si dhe

thënie shumë të thjeshta për të plotësuar nevoja konkrete. Nxënësi/sja mund të zotërojë një repertor të thjeshtë fjalësh të njohura dhe të memorizuara si dhe struktura gramatikore elementare, që i lejojnë të komunikojë në mënyrë të thjeshtë nëse bashkëfolësi flet ngadalë, qartë dhe tregohet bashkëpunues.

	Objektiva
Elemente gramatikore	<p>Në përfundim të klasës së 11-të, nxënës/i,-ja aftësohet në përdorimin e Elementëve morfologjikë si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • alfabeti, nyjet shquese dhe jo shquese, numrat; • numri, gjinia e emrave e mbiemrave; • mbiemrat cilësorë, gjinia, numri, vendi në fjali si dhe shkallët e mbiemrit cilësor; • mbiemrat pronorë; • përemrat vetorë dhe përemrat tonikë; • parafjalët; • mbiemrat dëftorë; • përemrat lidhorë qui, que, où; • ndajfoljet e vendit dhe të kohës; • ndajfoljet sasiore: shumë , pak, aspak; • ndajfoljet e kohës: shpesh, rrallëherë, asnjëherë; • zgjedhimi i foljeve të grupit I dhe grupit II; • foljet: jam dhe kam, mund, dua etj. foljet vetvetore; • kohët e foljeve: e tanishme, e kryer, e ardhme; • mënyra dëftore, mënyra urdhërore e foljeve; • format pavetore të foljeve: Il faut + infinitif; • format pohore, pyetëse, mohore të foljes. <p style="text-align: center;">Elementëve sintaksorë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • fjalia e thjeshtë dhe rendi i fjalëve në fjali. • funksionet kryesore në fjalinë e thjeshtë e të përbërë.

4. OBJEKTIVA SIPAS AFTËSIVE GJUHËSORE

Aftësia	Objektiva
Të dëgjuarit	<p>Në përfundim të klasës së 11-të, nxënës/i,-ja aftësohet</p> <ul style="list-style-type: none"> • të kuptojë një ndërhyrje nëse ajo është e ngadalshme dhe e shqiptuar me kujdes me pauza të gjata që lejojnë të kapet kuptimi; • të kuptojë udhëzime që i drejtohen ngadalë me fjalë të ndara mirë dhe me një diksion të qartë dhe të ndjekë orientime të shkurtra dhe të thjeshta; • të kuptojë numrat, kohën, ditët e javës, muajt e vitit, stinët, çmimet etj;

	<ul style="list-style-type: none"> të kuptojë dhe të reagojë ndaj një përshkrimit të temave të njohura në kohën e tashme, të shkruar ose të ardhme me anë të përsëritjes apo të përforcimit vizual.
Të lexuarit	<p>Në përfundim të klasës së 11-të, nxënës/i,-ja aftësohet</p> <ul style="list-style-type: none"> të përshtatë tingullin me simbolin për një lexim të saktë të fjalëve; të kuptojë tekste shumë të thjeshta dhe shumë të shkurtra, frazë pas fraze duke dalluar emrat, fjalët e njohura dhe shprehjet shumë elementare dhe duke rilexuar nëse është e nevojshme; të kuptojë mesazhe të thjeshta dhe të shkurtra në një kartolinë; të kuptojë informacione të thjeshta që lidhen me njerëzit dhe vendet përkatëse si vendbanimi, moshën, nacionalitetin etj; të dallojë vendin dhe kohën në afishe koncertesh, filmash, ndeshjesh, në lajmërimet apo postera; të kuptojë formularë dhe pyetësorë të thjeshtë që përmbajnë të dhëna personale; të dallojë emrat, fjalët dhe shprehjet më të përdorshme në situatat e zakonshme të jetës së përditshme; të formojë një ide mbi përmbajtjen e një teksti informativ mjaft të thjeshtë, veçanërisht nëse shoqërohet me një dokument pamor; të ndjekë treguesit e shkurtër dhe të thjeshtë (për shembull për të kaluar nga një pikë në tjetrën).
Të folurit	<p>Në përfundim të klasës së 11-të, nxënës/i,-ja aftësohet</p> <ul style="list-style-type: none"> të gjejë një zgjidhje të çastit me thënie tepër të shkurtra, të izoluara, në përgjithësi stereotipe, me mjaft pauza për të gjetur fjalën, për të shqiptuar ato më pak të njohurat dhe për të ndrequr komunikimin; të prodhojë shprehje të thjeshta të izoluara mbi njerëzit dhe sendet që e rrethojnë; të ndërveprojë në mënyrë të thjeshtë, por komunikimi varet krejtësisht nga përsëritja dhe nga debiti i ngadaltë, si dhe nga riformulimet dhe korrigjimet; t'u përgjigjet pyetjeve të thjeshta dhe të bëjë të tilla, të reagojë ndaj pohimeve të thjeshta dhe të bëjë të tilla në fushën e nevojave të menjëhershme ose mbi një temë shumë të njohur; të përdorë një repertor fjalësh dhe shprehjesh të thjeshta që lidhen me situata konkrete; të pyesë dikë për shëndetin dhe të reagojë ndaj pyetjeve të njëjta; të kuptojë dhe të përdorë shprehjet e përditshme për të

	<p>plotësuar nevojat e thjeshta e konkrete nëse ato përsëriten, formulohen drejtpërdrejt, qartë dhe ngadalë nga një bashkëfolës që bashkëpunon dhe mirëkupton;</p> <ul style="list-style-type: none"> • t'i kërkojë diçka dikujt dhe t'ia japë atij; • të manovrojë me numrat, sasi, lekët dhe orën; • t'u përgjigjet pyetjeve të thjeshta dhe të bëjë të tilla; mund të reagojë ndaj deklaratave të thjeshta dhe të bëjë të tilla, në rast nevojë imediate ose mbi tema të njohura ; • të bëjë pyetje personale, për shembull, mbi vendin e banimit, njerëzit që e rrethojnë, dhe mund t'u përgjigjet pyetjeve të tilla ; • të flasë për kohën me shprehje të tilla si: javën e ardhshme, të premten e fundit, në nëntor, në orën 3.... ; • t'u përgjigjet në një intervistë pyetjeve personale të bëra ngadalë dhe qartë dhe në një gjuhë të drejtpërdrejtë dhe jo idiomatike; • të thotë kur kupton ose nuk kupton diçka dhe duhet t'ia ripërsërisin ;
<p>Të shkruarit</p>	<p>Në përfundim të klasës së 11-të, nxënës/i,-ja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të kopjojë shprehje të shkurtra dhe fjalë të përdorimit familjar, për shembull të dhëna ose këshilla të thjeshta, emrat e objekteve të përditshëm, emrat e dyqaneve dhe një sërë shprehjesh që përdoren rregullisht; • të plotësojë një formular të thjeshtë (me adresën e tij, kombësinë e tij dhe informacione të tjera personale të këtij lloji); • të shkruajë shprehje dhe fraza të thjeshta të veçuara; • të shkruajë fraza dhe shprehje të thjeshta për veten dhe personazhe imagjinarë, (ku jetojnë ata dhe çfarë bëjnë); • të kërkojë dhe të transmetojë me shkrim udhëzime personale të hollësishme; • të shkruajë një kartolinë të thjeshtë dhe të shkurtër; • të shkruajë shifra dhe data, emra, kombësi, adresa, mosha, datëlindje, datën e mbërritjes në një vend, etj. në një regjistër hoteli, p.sh: • të shkruajë shënime të thjeshta për të treguar se ku ndodhet dhe kur do të takohet me dikë. • të shkruajë duke përdorur struktura gjuhësore të thjeshta ose modele fjalish mbi të cilat zotëron një kontroll të kufizuar. • të shkruajë me një fjalor të kufizuar brenda situatash konkrete të veçanta.

5. KËRKESA TE GJUHËS FRËNGE NDAJ LËNDËVE TË TJERA

Mësimi i gjuhës së huaj synon ndërveprimin mes lëndëve dhe disiplinave të ndryshme duke realizuar mësimin e gjuhës së huaj të shoqëruar me përvetësimin e elementeve të artit, kulturës, civilizimit etj. Gjuha e huaj shërben si mjet për të zgjeruar njohuritë dhe mësohet më lehtë e pasurohet nga dijet që vijnë nga fusha të tjera. Kjo e ndërjegjëson mësuesin e gjuhës së huaj për një ndërveprim me mësues të lëndëve të tjera dhe domosdoshmërinë e një lidhjeje ndërkurrikulare.

Lëndët me të cilat mund të ndërveprojë gjuha e huaj janë:

Historia e artit, në programin e së cilës trajtohet zhvillimi i artit në periudha të ndryshme të zhvillimit të tij, si arti gotik dhe karakteristikat e tij, simbol i të cilit konsiderohet Katedralja e Parisit, Rilindja franceze me përfaqësuesit e saj etj.

Historia, e cila me ngjarje dhe fakte të rëndësishme mund të ndihmojë në formimin kulturor e intelektual të nxënës/it,-es, njohjen e vlerave historike-shoqërore të popullit francez, personaliteteve të shquara etj. (p.sh. Revolucioni Borgjez i vitit 1789, Napoleoni, mbretërit e Francës, lufta 100 vjeçare Zhan d'Ark etj.).

Gjeografia, me anën e së cilës marrim njohuri për vendet turistike në Francë, duke lehtësuar kuptimin e temave për udhëtimet, traditat kulturore, zakonet turistike, kulturën e pushimeve ose të kohës së lirë, në Francë; parapëlqimet, shijet që lidhen me to etj.

Filozofia, duke shtjelluar çështje të formimit intelektual e shpirtëror të francezëve në periudha të ndryshme të zhvillimit të historisë, ndihmon në njohjen e mënyrës së menduarit, dhe të vepruarit në vende dhe periudha të ndryshme p.sh duke folur për revolucionin dhe sloganin e tij thellohem në të drejtat e njeriut, vlerat morale e politike të këtij revolucioni etj.).

Sociologjia, mund të lehtësojë në të kuptuarit e dokeve, zakoneve, vlerave shoqërore të një populli të huaj që kushtëzohen nga një kontekst shoqëror dhe një realitet i ndryshëm nga i yni. Vetë njohja e gjuhës së huaj dhe e një kulture të huaj kultivon tek nxënës/i,-ja ndjenja të tolerancës, pranimit të diversitetit etj., që lidhen ngushtë me zbatimin e të drejtave të njeriut dhe edukimin qytetar, si një nga bazat themelore të bashkëveprimit në Evropë.

6. KËRKESA PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Ky program është një dokument zyrtar, pjesë e tërësisë së dokumenteve zyrtare për lëndën e Gjuhës Frënge. Dokumentet e tjera kryesore janë korniza kurrikulare e gjimnazit dhe standardet e fushës kurrikulare ku kjo lëndë bën pjesë. Hartimi i programit është mbështetur si te korniza kurrikulare, ashtu edhe te standardet e fushës të përshtatura për shkollën e mesme të gjuhëve të huaja.

Për të siguruar përdorimin sa më të mirë të programit është e vlefshme njohja me dokumentet e lartpërmendura.

Te korniza kurrikulare vëmendje e veçantë i duhet kushtuar:

- Synimeve të përgjithshme të kurrikulës së shkollës së gjuhëve të huaja,
- vlerësimin të nxënës/it,-es me notë,
- parimeve të mësimdhënie-mësimnxënies.

Gjithashtu, përdoruesve të këtyre dokumenteve u lind nevoja të njohin standardet e të gjitha fushave të tjera të të nxënës dhe të gjitha programet lëndore të të njëjtit vit, për të siguruar një ndërveprim ndër-lëndor.

Zbatimi i programit duhet të bëhet duke respektuar parimet e barazisë gjinore, etnike, kulturore, racore dhe fetare.

A. Objektivat

Bazuar në orientimet mbi objektivat e arritjeve në procesin mësimor është e rëndësishme që mësuesi të përshtatë veprimtarinë mësimore në vartësi të niveleve të ndryshme në klasën e gjuhës.

Objektivat e programit janë për të gjithë nxënësit dhe janë detyrim për përdoruesit e programit. Kjo do të thotë se që të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia që të nxënë çka përshkruhet tek objektivat. Realizimi i objektivave në tema, kapituj, njësi dhe renditja e tyre është zgjedhje e lirë e zbatuesit të programit. Shembulli më poshtë është thjesht për ilustrim:

Objektivi: “Zhvillimi i punës me shkrim në nivelin **A1+**

Kërkesa e detyrës: hartoni bashkëbisedimin mes dy personave në situatën e poshtëshënuar presupozon përgatitjen dhe ushtrimin e të gjithë nxënësve për realizimin e këtij objektivi. Nëse një mësues nuk e bën këtë, nuk ka zbatuar programin lëndor. Një objektiv përmbushet në nivele të ndryshme nga nxënës/e të ndryshëm. Mësuesi dhe autorët e materialeve mësimore duhet të mbulojnë të gjithë gamën e niveleve të nxënësve.

Objektivi: “Të flasësh mbi një dokument pamor” (psh një kartolinë, ose një foto që paraqet një pamje x)

Të gjithë nxënësve duhet t'u jepet mundësia të punojnë mbi një dokument autentik. Në një nivel të ulët mësues/i,-ja i kërkon nxënës/it,-es thjesht të dallojë dhe të emërtojë një nga një objektet e njohura që sheh në foto: p.sh pemë, njerëz, ndërtesa, lumenj etj.

Në një nivel më të lartë ai u propozon një grup nxënësish të tregojnë në mënyrë të përmbledhur, me fraza të shkurtra, elementare se çfarë shohin në foto dhe si janë vendosur ato (majtas, djathtas, poshtë, lart, ngjyrat e paraqitjes së peizazhit etj).

Në një nivel edhe më të lartë mësuesi do t'u propozonte nxënësve më të mirë të nxjerrin konkluzione nga fotoja dhe të formulonin një ide qendrore (p.sh çfarë mendimi ju sjelle ndër mend fotoja, çfarë problematike trajton p.sh. ruajtjen e mjedisit, bukurinë e natyrës organizimin e kohës së lirë etj).

B. Orët mësimore

Programi i gjuhës frënge për klasën e 11-të për fillestarë, është strukturuar në linja që vijnë njëra pas tjetrës, por nuk do të thotë se mësimdhënia-mësimnxënia duhet të zhvillohet në këtë renditje gjatë vitit shkollor.

Sasia e orëve mësimore për secilën linjë është rekomanduese. Përdoruesit e programit duhet të respektojnë sasinë e orëve vjetorë të lëndës, por janë të lirë të ndryshojnë me 11-të% (shtesë ose pakësim) orët e rekomanduara. Mësuesi mund të vendosë të përparojë më ngadalë kur ve re se nxënësit hasin vështirësi të veçanta në përmbushjen e objektivave të kapitullit, por mund të ecë më shpejt kur ata demonstrojnë një përvetësim të kënaqshëm.

Në programin e lëndës së gjuhës frënge, afërsisht **70%** e orëve mësimore totale janë për shtjellimin e njohurive të reja lëndore dhe **30%** e tyre janë për rimarrjen dhe përpunimin e njohurive (gjatë vitit dhe në fund të vitit shkollor).

Shpërndarja e orëve mësimore

Pjesë e përpunimit të njohurive është edhe rishqyrtimi vjetor i cili ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe të përforcojë konceptet e metodat themelore të kësaj lënde.

Programi i klasës së 11-të për fillestarë orienton gjithë procesin e mësimdhënies e të nxënies së gjuhës frënge në nivelin **A1+**.

Mësuesi është i lirë të përdorë një larmi metodash e strategjish të mësimdhënies/ nxënies për t'ia përshtatur nevojave të nxënësve në klasa të ndryshme. Ai i kombinon këto metoda gjatë procesit mësimor dhe i përshtat ato në bazë të zhvillimit në rritje të kompetencave gjuhësore dhe të zhvillimit të pavarësisë së nxënësve në vijueshmëri të këtij procesi.

Gjuha frënge për klasën 11-të fillestar në shkollën e mesme të gjuhëve të huaja zhvillohet me 3 orë mësimore në javë (**36 javë x 3 orë = 108 orë vjetore**) dhe shpërndarja e orëve të planifikuara është si vijon:

Gjatë shtjellimit linear të lëndës në tekst (në unitete e njësi mësimore) fushat dhe aftësitë gjuhësore dhe linja(kultura) ndërthuren me njëra-tjetrën. Mësuesi është i lirë të bëjë kombinimin e tyre brenda një uniteti ose një njësie mësimore, pavarësisht renditjes në tabelën e shpërndarjes së orëve.

Komunikimi dhe formimi kulturor zë 85 orë, të cilat ndahen, sipas objektivave që u përgjigjen, në 60 orë mësimore për kulturën dhe komunikimin (nga të cilat 70% e tyre, që përbëjnë 42 orë, do të jenë për trajtimin e lëndës së re, kurse 30% e tyre, që përbëjnë **18** orë, do të shërbejnë për përpunimin e njohurive; me përpunim do të kuptojmë, p.sh., përforcimin e informacionit të marrë në temat përkatëse ose ushtrime për mendimin kritik rreth këtij informacioni) dhe 25 orë për aktet dhe funksionet e komunikimit (nga të cilat 70% e tyre), që përbëjnë 18 orë mësimore, do të shërbejnë për njohuritë e reja, kurse 30% e tyre, d.m.th. **7** orë mësimore, do të përdoren për përpunimin e njohurive. Këtu mësuesi bën përpunim njohurish për integrimin tërësor të lëndës, d.m.th. ai jep detyra komplekse, ku pasqyrohen njohuritë e përfutuara sipas aftësive dhe objektivave në një unitet.

Formimi gjuhësor zë 23 orë. Janë kryesisht orë në të cilat mësuesi shtjellon, në bashkëveprim me nxënësit njohuri gramatikore dhe ushtrime gjuhësore gramatikore e leksikore (nga të cilat 70% e tyre, që përbëjnë 16 orë mësimore, do të shërbejnë për trajtimin e strukturave të reja, kurse 30% e tyre, që përbëjnë 7 orë, do të shërbejnë për rimarrjen, përpunimin dhe përforcimin e tyre).

Përpunimi i njohurive

Përpunimi i njohurive përmban:

- përsëritjen e njohurive-bazë (konceptet themelore);
- testimin e njohurive-bazë;
- integrimin e njohurive të reja të lëndës me njohuritë e fituara më parë;

Gjatë përpunimit të njohurive duhet t'i kushtohet kohë e posaçme kultivimit të:

- aftësive të përgjithshme, si: të komunikimit, të menaxhimit të informacionit, të zgjidhjeve problemore dhe të të menduarit krijues;
- aftësive gjuhësore, të dëgjuarit, të lexuarit, të folurit dhe të shkruarit.
- formimit të qëndrimeve, si qëndrimin etik-social dhe gjatë punës në grupe të vogla nxënësish.

Në orët mësimore, që i përkasin përpunimit të njohurive, mësuesi zhvillon edhe tema me nismën e tij ose me kërkesën e vetë nxënësve. Këto tema mund të kenë pikënisjen nga ngjarje aktuale ose thjesht nga kureshtja e nxënësve.

Gjatë orëve të përpunimit të njohurive, nxënësve duhet t'u krijohet mundësia të punojnë detyra tematike e projekte kurrikulare, të zgjidhin situata problemore nga jeta etj. Pjesë e përpunimit të njohurive është edhe përsëritja e cila ka për qëllim të nxjerrë në pah dhe të përforcojë konceptet kryesore.

Testet e Kontrollit. DELF- A1+ ashtu si vetë strategjia e mesimdhënjes duke synuar qëllimet e vetë mësimin të gjuhës së huaj **në kuadrin e referencave**, synojnë nivelin **A1+** të këtij kuadri, mësimin dhe zotërimin e strukturave respektive duke punuar me grup nivele të nxënësve, duke synuar arritjen e objektivave sipas niveleve të të nxënësve.

Metoda dhe strategji të mesimdhënies/nxënies.

Mësimdhënia ka në qendër të saj metodën komunikative, metoda me bazë detyrën, metodën funksionale dhe atë të situatave sa më afër jetës reale etj.

Në këtë nivel (A1+), mësuesi do të vazhdojë të adoptojë një metodologji që e konsideron gjuhën si sistem dhe për rrjedhojë, të koordinojë veprimtari që synojnë të katër aftësitë, dmth: të punojë me kompetenca të integruara.

Sidoqoftë në këtë fazë, ai mban parasysh se nxënës/i,-ja është një lexues fillestar që mund të hasë shumë vështirësi, ndaj ai e grish në disa strategji të leximit që shmangin bllokimin nëpërmjet të kuptuarit global të tekstit, si dhe në një lexim me shqiptim të saktë intonativ dhe prozodik, gjithmonë në funksion të kuptimit të tekstit. Ndonëse në hapat e para, mësuesi mban parasysh se nxënësi nëpërmjet një procesi evolutiv ti përshtatet nivelit të mbijetesës, duke synuar origjinalitet pa influenca të dukshme të gjuhëve të studiuara tashmë.

Në këtë fazë mësuesi bën kujdes të ndërhyjë me gjuhën amtare në dhënien dhe shpjegimin e vështirësive dhe keqkuptimeve, njëkohësisht ai në rastin e mosnjohjes së gjuhëve të studiuara nga nxënësi në krahasimin, hulumtimin mbi konvergencat dhe divergjencat në strukturat e gjuhëve në fjalë.

Mësuesi mund të ndryshojë funksionin e caktuar të teksteve dhe të dokumenteve. Për një tekst të dhënë, veprimtaritë e propozuara do të ndryshojnë sipas qëllimit, pra, nëse lexojmë për të kuptuar përmbajtjen p.sh. apo për një sensibilizim lidhur me përdorimin e kohëve foljore ose për të gjetur emrat e objekteve, të profesioneve të njohura dhe të mësuara më parë, etj.

Mësuesi duhet të mbajë vazhdimisht parasysh rritjen e shkallës së vështirësisë ose dozimit në formulimin e kërkesave të detyrave dhe ushtrimeve që do të propozojë, sidomos në fazën e shfrytëzimit të orëve për përforcimin e njohurive (30%), që të sigurojë një proces evolutiv të mësimdhënies/nxënies.

Metodologjia e ndjekur nga mësuesi synon kalimin nga më e njohura te më pak e njohura, nga proceset e automatizuara tek ato krijuese.

Për sa i përket të mësuarit të gjuhës në përgjithësi, mendojmë se vetëm të kuptuarit nuk mund të çojë në mësimin e plotë të gjuhës: është krijimi ai që në fund të fundit, është vendi i praktikimit të njohurive. Duke konsideruar lehtësitë dhe problemet që sjell mësimi i një gjuhe të tretë në shkollën e mesme, mësuesi i lë një hapësirë shumë të vogël produktit me shkrim, duke favorizuar operacionet e nivelit hyrës si proceset memorizuese, përdorimin e modeleve të gatshme dhe të automatizuara, në mënyrë që nxënësi të diferencojë dhe të arrijë të formulojë drejt konceptet e studiuara.

Në këtë nivel, synohet të krijohen kushtet e përshtatshme kryesisht për t'u shprehur por edhe për të shkruar minimalisht. Duke pasur parasysh se në këtë nivel fillestar, kur nxënësi punon paralelisht për përvetësimin e tre gjuhëve, vështirësitë janë të mëdha, për më tepër që duke qenë të rritur nxënësit bëhen më hezitues, mësuesi parapëlqen punën në grupe për tu krijuar situata lirshmërie për tu shprehur rreth temave të trajtuara. Është fjala për të vënë në përdorim gjithçka, për të krijuar një klimë të përshtatshme në klasë.

Për një mësimdhënie të gjuhës për qëllime komunikimi, është e domosdoshme të krijosh një motivim për të folur që të jetë sa më i justifikuar: simulim nevojash (vënie në skenë në klasë, simulime të përgjithshme, situata komunikimi të qarta), parashikim i nevojave (përdorim i gjuhës së huaj për parashikime, për qëllime të caktuara, studimi apo turizmi, për shembull), nevoja reale, brenda klasës ose që vijnë nga kontaktet jashtë klasës (punë në grupe, shfrytëzim i mjedisit, shkëmbimet midis shkollave, letërkëmbimet telematike, me internet, ose me kaseta audio dhe video), por edhe kënaqësia për të luajtur, për të komunikuar, për t'u shprehur dhe për të dëgjuar tjetrin.

Njëkohësisht mësues/i,-ja duhet të punojë që nga ana e nxënës/it,-es të përdoren në shërbim të arritjes së objektivave të gjitha strategjitë e nevojshme për formimin e aftësive gjuhësore repsektivisht:

Të dëgjuarit

Për të zhvilluar aftësinë e të dëgjuarit, nxënës/i,-ja ushtrohet të ndjekë këto strategji:

- të përqendrohet gjatë dëgjimit
- të mbajë shënime gjatë dëgjimit;
- të klasifikojë çështjet që dëgjon;
- të bëjë lidhje mes asaj që dëgjon dhe materialit pamor;

- të përqendrohet te kërkesa e dëgjimit;
- të vëre qëllime dhe objektiva për zhvillimin e aftësisë së dëgjimit;
- të përipiqet që gjatë dëgjimit të kuptojë referencat kulturore duke i krahasuar ato me respektivet në kulturën kombëtare.

Të folurit

Për të zhvilluar aftësinë e të folurit, mësuesi/i,-ja ushtron nxënës/in,-en të ndjekë këto strategji:

- t'i kërkojë bashkëbiseduesit përsëritje, në rast moskuptimi;
- të mos ndalojë plotësisht ligjërimin, kur nuk di një fjalë ose shprehje, por të përdorë shprehje e fjalë të njohura që shpjegojnë situatën;
- të përdorë shprehje dhe gjeste tipike te gjuhës frënge, me qëllim që të fitojë kohë për gjetjen e fjalës së duhur;
- të përsërisë një pjesë të asaj çka thotë bashkëbiseduesi, për të miratuar se biseda ndërmjet tyre po përcillet në mënyrë të drejtë kuptimore;
- të pyesë bashkëbiseduesin për të bërë të qartë atë që është thënë.

Të lexuarit

Për të zhvilluar aftësinë e të lexuarit, mësuesi/i,-ja ushtron nxënës/in,-en të ndjekë këto strategji:

- të kërkojë të dhëna që e ndihmojnë për të parashikuar përmbajtjen e tekstit, si: figura, titulli i mësimit, dy rreshtat e parë të mësimit;
- të lexojë tekstin dhe të nxjerrë kuptimin e fjalëve të panjohura në kontekst;
- të lexojë pyetjet rreth tekstit dhe të hamendësojë përgjigjet e mundshme;
- të gjejë përgjigjet e pyetjeve në tekst, duke përcaktuar paragrafin që u përket pyetjeve.

Të shkruarit

Për të zhvilluar aftësinë e të shkruarit, mësuesi/i,-ja ushtron nxënës/in,-en të ndjekë këto strategji:

- të plotësojë vendet bosh në paragrafin e dhënë me informacion mbështetës, si: shembuj, sqarime etj.;
- të kontrollojë lidhjen logjike të paragrafëve, duke përdorur lidhëzat përkatëse;
- të redaktojë shkrimin të mbajë shënime për atë çfarë i kërkohet në detyrën e caktuar; e tij ose të këmbejë punën e tij me atë të shokut.

Parime për zbatimin e programit

Zbatimi i programit mbështetet në parimet e mëposhtme:

Vendosja e nxënës/it,-es në qendër të vëmendjes

Programi i gjuhës frënge rrit njohuritë gjuhësore të nxënës/it,-es përmes temave që i përshtaten interesave dhe nevojave të tij/saj gjuhësore dhe shoqërore, duke i dhënë mundësi nxënësit të jetë në qendër të procesit mësimor. Strategjitë e

parashikuara nxisin ndërveprimin gjuhësor dhe komunikativ, duke e përfshirë nxënës/in,-en në organizimin e veprimtarive dhe përdorimin e teknikave që i përshtaten individualitetit të tij/saj, duke i forcuar besimin në komunikimin ndëraktiv në gjuhën frënge.

Krijimi i mjedisit të të nxënit

Krijimi i një atmosfere gjuhësore motivuese dhe konkurruese, si dhe i një ambienti miqësor, emocional duke synuar demokratizimin e mësimin dhe mardhënieve në shkollë. Krijimi i mjedisit të përshtatshëm të të nxënit ndihmuar nga mjetet e teknologjisë në funksion të të mësuarit lehtëson përdorimin e formave të bashkëpunimit në klasë.

Organizimi i klasës

Mësues/i,-ja dhe nxënësit bashkëpunojnë për organizimin e mësimdhënies/nxënies. Për ta lehtësuar mësimdhënien/nxënien, mësuesi/ja gjen mënyra frytdhënëse për të organizuar veprimtaritë komunikuese, siguron dhe sugjeron materiale burimore për nxënësit etj. Mësues/i,-ja i qartëson nxënësit dhe merr mirëkuptimin e tyre për atë çfarë ndodh në klasë. Kjo nënkupton sqarimin e rregullave të radhës së punës dhe përgjegjësi të nxënësve në procesin e kryerjes së veprimtarive.

Mësues/i,-ja sugjeron dhe siguron përdorimin e mjeteve audiovizuale, elektronike dhe ndihmon nxënës/in,-en në përdorimin e formave të ndryshme të teknologjisë informative brenda dhe jashtë klase. Ai/ajo u jep nxënësve epërsitë në përputhje me moshën dhe kërkësat shkollore.

Të mësuarit bashkëveprues

Mësues/i,-ja krijon kushtet për realizimin e mësimin në mënyrë bashkëkohore, të të mësuarit bashkëveprues realizuar në grupe apo çifte, duke siguruar ndërveprimin gjuhësor dhe bashkëpunimin mes nxënësve gjatë organizimit të veprimtarive në klasë. Ai/ajo përdor forma të larmishme që i përshtaten nivelit dhe veçorive individuale të nxënësve. Ato variojnë nga ndërveprimi në çift apo në grup. Këto forma i bëjnë nxënësit më bashkëveprues, më të pavarur në shprehjen e mendimit të tyre dhe respektimin ndaj ideve të të tjerëve.

Përdorimi i gjuhës në klasë

Në nivelin gjuhësor A1+, nxënësi është më i formuar nga ana gjuhësore e kulturore dhe është i gatshëm të përdorë gjuhën frënge në situata të thjeshta komunikimi për veprimtari që lidhen me kontekstin e përditshëm.

Të mësuarit e gramatikës

Në kuadër të respektimit të Kuadrit të Referencave për Gjuhët, gramatika mësohet në bashkëveprim dhe në një kontekst të thjeshtë, referuar kërkesave të nivelit A1+ Njohuritë gjuhësore janë në shërbim të funksionit komunikativ të gjuhës, cilësia e të cilit varet nga saktësia gramatikore dhe rrjedhshmëria gjuhësore

Qortimi i gabimeve

Programi i gjuhës frënge për klasën e 11-të pasqyron më së miri mënyrën e korrigjimit të gabimeve. Niveli A1+ parashikon që nxënësit të aftësohen që të vetë korrigjohen ose të korrigjojnë njëri-tjetrin, dhe të mësojnë prej gabimeve që ata bëjnë. Shpesh mësues/i,-ja shënon gabimet e përsëritura dhe, kur është e nevojshme, dhe i korrigjon ato, duke i qartësuar dhe duke përdorur format e sakta gjuhësore në strukturë për të formuar tek nxënësin shprehë për strukturën e dhënë.

Puna e diferencuar me nxënësit

Në kushtet e mësimdhënies së gjuhës së huaj në shkolla kombëtare të profilit gjuhësor mësuesi i gjendur para nxënësish me prejardhje krahinore domethënë karakteristika fonologjike të ndryshme, me prirje dhe dëshira të larmishme, me temperamente dhe interesa të shumëllojshme duhet të konceptojë në punën e tij edhe një dimension të punës së diferencuar, me grupe dhe me nxënës të veçantë.

Një nga metodat e punës për të siguruar ndërveprimin në mësimin e gjuhës së huaj është puna në grupe, në të cilën mësuesi duhet të konceptojë veprimtari të larmishme që tërheqin vëmendjen e interesat e grupeve dhe nxënësve të veçantë. Mësuesi mund të krijojë grupe të përziera me nxënës/e të përparuar dhe të prapambetur duke caktuar detyra në grup për të mos i vënë në vështirësi nxënësit dhe për t'i inkurajuar ato të zgjidhin detyra e mundshme. Duke synuar objektiva të arritjeve gjithnjë në rritje mësuesi duhet të konceptojë detyra të larmishme me shkallë vështirësie në rritje duke dhe vlerësuar nxënësin në progres.

Nxënësit e përparuar mund të sjellin një kontribut të konsiderueshëm nëpërmjet transferimit të njohurive të tyre nga gjuha dhe kultura amtare në gjuhën dhe kulturën e huaj dhe anasjelltas. Mësuesi bashkërendon punën për veprimtari paralele me mësuesit e gjuhës amtare si dhe gjuhëve të tjera si motra.

Gjatë ushtrimit të detyrës së tij mësuesi duhet:

- të dëgjojë me kujdes nxënësit kur flasin dhe t'u japë përgjigje në kohën e duhur;
- të ndjekë ecurinë e çdo idividi duke mbajtur shënimet përkatëse;
- të ndajë përgjegjësitë e nxënësve për veprimtaritë individuale apo në grup;
- të vlerësojë peridikisht punën e nxënësve, jo vetëm me notë por edhe me komente për punën e tyre;
- të kërkojë prej tyre mendime dhe sugjerime të punës së tyre, me qëllim që të përmirësojë mësimdhënien;
- të motivojë nxënësit të zhvillojnë strategjitë e tyre individuale të të mësuarit të gjuhës frënge;
- të nxisë pjesëmarrjen e nxënësve indiferentë në punën në grup dhe të nxjerrë në pah punën e tyre në klasë, duke u dhënë role drejtuese në punët në grup.

7. VLERËSIMI

Programi i gjuhës frënge për klasën e 11-të, mbështetet në Kuadrin e Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët dhe në Portofolin Evropian për Gjuhët, i cili jo vetëm përshkon gjithë procesin mësimor, por shërben edhe për

përmirësimin e këtij procesi. Vlerësimi si një nga aspektet përbërës të këtij programi siguron:

- një matje të vazhdueshme të ecurisë së nxënës/it,-es në gjuhën frënge;
- një informacion për rivlerësim të përmbajtjes lëndore dhe të metodave të mësimdhënies, si dhe cakton detyrat për të ardhmen;
- një plan pune për përmirësim e njohurive të nxënës/it,-es;

Vlerësimi mbështetet tërësisht në objektivat e programit lëndor dhe mësuesi nuk ka të drejtë të vlerësojë nxënës/in,-en për ata objektiva të arritjes që nuk përshkruhen në program. Vlerësimi duhet t'i përmbahet vetëm standardeve që përkojnë me nivelit A1+ të parashtruara në program.

Vlerësimi nuk përfshin vetëm realizimin e standardeve rreth njohurive dhe aftësive, por edhe qëndrimet e nxënësve, si p.sh. qëndrimet etiko-sociale në përgjithësi dhe ato të bashkëpunimit me të tjerët, në veçanti.

Vlerësimi i nxënës/it,-es duhet të jetë sa më objektiv dhe i matshëm, gjë që tregohet më së miri në realizimin e standardeve. Mësues/i,-ja vlerëson vetë dhe ndihmon edhe nxënësit që të përdorin një larmi mënyrash vlerësimi e vetvlerësimi.

Vlerësimi mund të organizohet në disa forma:

- Vlerësimi i dijeve (në bazë niveli), ku përfshihet vlerësimi i objektivave specifike. Ky vlerësim ka lidhje me atë çka është mësuar gjatë një jave, muaji ose semestri, pra me punën që është bërë me tekstin dhe programin.
- Vlerësimi i kapaciteteve (ose i zbatimit të aftësive, ose i performancës) që është vlerësimi i asaj çka nxënësit mund të bëjnë ose dinë në raport me zbatimin e saj në jetën e përditshme.
- Vlerësimi mund të bëhet individual ose në grup, në klasë ose jashtë saj. Nxënës/i,-ja vlerësohet me notë, ndërsa demonstroi arritjet e tij/saj me gojë, me shkrim,.

Vlerësimi me shkrim dhe me gojë

- Vlerësimi formues, me anë të të cilit merret informacion rreth asaj që është arritur nga nxënës/i,-ja në formimin e tij/saj gjuhësor, në përputhje me objektivat e caktuar.
- Vlerësimi diagnostikues, i cili bëhet në mënyrë të vazhdueshme, për të marrë informacion rreth përgatitjes ditore dhe përvetësimit të materialit gjuhësor të dhënë më parë.
- Vlerësimi i planifikuar mbi bazën e realizimit të objektivave të mësimin, pra në bazë kapitulli ose të një ore mësimore. Ky vlerësim bëhet me notë dhe realizohet në fund të çdo mësimi përsëritës (ose kapitull).
- Vlerësimi motivues, ndihmon për të nxitur dëshirën e nxënës/it,-es për mësimin e gjuhës frënge. Ky vlerësim është i vazhdueshëm dhe gjatë gjithë procesit mësimor. Duke inkurajuar nxënësin të përdorë materiale që nxisin vlerësimin motivues të tij. Përgatitja e dosjes së arritjeve të nxënës/it,-es si pjesë e Portofolit Evropian të Gjuhëve, ku ai vendos çertifikata, provime, projekte, dëshmi etj. provojnë ecuri të tij/saj në gjuhë si dhe shërbejnë si mjet vetëvlerësimi dhe vlerësimi.

Vlerësimi me notë

Vlerësimi i nxënës/it,-es bëhet me notë sipas sistemit të vlerësimit të vendosur nga MASH-i dhe AVA. Ky vlerësim nuk përfundon me vendosjen e notës. Ai përqëndrohet tërësisht në monitorimin dhe vlerësimin e njohurive të nxënësve të përfutuara në vazhdimësi, si dhe të rezultateve të arritura gjatë procesit të mësimdhënies/nxënies, kryesisht kur gjuha frënge është provim përfundimtar si lëndë më zgjedhje.

Vlerësimi përfundimtar

Në përfundim të semestrit të parë, për çdo nxënës/e dhe lëndë përllogaritet nota semestrale dhe në përfundim të vitit shkollor, nota vjetore. Nota e semestrit të parë dhe ajo vjetore përllogariten duke pasur si të dhëna fillestare të gjitha notat e nxënës/it,-es të shënuara në regjistër. Notat gjatë vitit shkollor nuk kanë të njëjtën peshë në njehsimin e notës semestrale dhe asaj vjetore. Pesha e një note përcaktohet nga lloji i saj. Janë katër lloje:

- vlerësimet e përditshme,
- provimet periodike me shkrim,
- provimi përfundimtar,
- Duhet treguar kujdes që:
- Para testimit duhet bërë një model, që t'u tregohet nxënësve se si do të bëhet testimi.
- Caktohen më parë qëllimet e testimit për të kaluar më pas në zhvillimin e tij.
- Vlerësimi mund të jetë individual ose në grup.

Është mirë që pyetjet në test të renditen sipas shkallës së vështirësisë së tyre. Zakonisht në një test, (p.sh.: në fund të një kapitulli) kërkohen që 30% të pyetjeve të jenë të nivelit të parë, 50% të nivelit të dytë dhe 20% të nivelit të tretë. Numri i pyetjeve në test varet nga ajo çka duhet testuar (një mësim, kapitull apo një koncept.)

Disa udhëzime për vlerësimin.

Është e domosdoshme që mësues/i,-ja të mos përdorë vetëm një formë vlerësimi, por larmi formash. Ato duhet t'u krijojnë nxënësve mundësi të vlerësohen në atë mënyrë që është e përshtatshme për çdo nxënës. Kështu, p.sh. një nxënës/e përgjigjet më mirë me gojë, një tjetër me shkrim, njëri i shpreh bukur dhe me emocion mendimet në një pyetje të hapur, një tjetër jo, etj.

Në vlerësimin e përfundimtar të nxënësve të vlerësohen me kompetencë rezultat i aftësive të tij dhe jo rezultat i një mesatareje aritmetike të rezultateve të tij. Vonesat e dhënies së përfundimeve të vlerësimit dhe mosanaliza e tyre nga mësues/i,-ja e ulin shumë vlerën e korrigjimit të gabimeve. Mësues/i,-ja zhvillon vetë si dhe ndihmon nxënësit dhe së bashku zhvillojnë një larmi mënyrash vlerësimi.

Metodat e vlerësimit të përdorura në gjuhë të huaj do të përfshijnë:

- teste me shkrim për të kontrolluar arritjet e nxënësve në lidhje me objektivat e programit,
- monitorimin e punës në grup të nxënësve,

Vlerësimi me shkrim shërben për aftësimin e nxënësve në komunikimin me shkrim dhe mund të realizohet jo vetëm me laps e letër, por edhe në rrugë elektronike. Mësues/i,-ja vlerëson nxënës/in,-en me notë për parashtrimet me shkrim në provimet

periodike me shkrim dhe në prezantimet me shkrim të punimeve të tij/saj, të zhvilluara vetë ose në grup. Mësues/i,-ja planifikon provime periodike me shkrim për blloqe të gjera orësh mësimore, që përbëhen nga një apo disa kapituj, të cilët i bashkojnë objektiva të ndërlidhura të nxënësve. Në përshtatje me qëllimin e vlerësimit me shkrim, ai/ajo përdor lloje të ndryshme testesh, që nga minitestet disa minutëshe për një objektiv të veçantë të nxënësve, tek ato njëorëshe. Planifikohen teste me alternativa ose zhvillim, detyra tematike, projekte kurrikulare etj.

Portofoli i nxënës/it.-es, si një mundësi vlerësimi e vetëvlerësimit, është një koleksion i punimeve përgjatë vitit shkollor për gjuhën frënge. Portofoli i nxënës/it.-es mund të përmbajë provime me shkrim, detyra tematike, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare. Përzgjedhjet për portofolin bëhen nga nxënës/i,-ja, ndërsa mësues/i,-ja rekomandon.

Mësuesi duhet të marrë në konsideratë vështirësi të veçanta gjuhësore të nxënësve të ardhur rishtas nga emigracioni, duke u mundësuar këtyre nxënësve të vlerësohen me mënyra inkurajuese.

Vetëvlerësimi:

Vetëvlerësimi është një tjetër element i rëndësishëm i vlerësimit në mësimin e gjuhës frënge, ku secili nxënës/e jep gjykimin për zotësinë e vet. Vetëvlerësimi është një element plotësues i domosdoshëm i vlerësimit të njohurive nga mësues/i,-ja, nga prindërit dhe institucionet e tjera. Vetëvlerësimi ka efekt kur:

- u referohet normave dhe kapacitetit që Kuadri i Referencave për Gjuhët parashtron për grupmoshën dhe nivelin e tyre,
- lidhet me një përvojë të veçantë gjuhësore e ndërkulturore.

Vetëvlerësimi i nxënësve bëhet i matshëm nëpërmjet përcaktimit të synimeve të qarta në program. Si mjet në vetëvlerësim shërben Portofoli Evropian i Gjuhëve (PEGJ), që me anë të tri pjesëve të tij: Pasaportës Gjuhësore, Biografisë gjuhësore dhe Dosjes, nxit nxënës/in të mendojë mbi nivelin e tij gjuhësor, duke vetëvlerësuar njohuritë e marra, dhe dokumentimin e arritjeve të tij gjuhësore të cilat mund të jenë: provime me shkrim, detyra tematike, çertifikata, projekte kurrikulare, fotografi e produkte të veprimtarive kurrikulare.

PEGJ-i është dokumenti që çdo nxënës shënon eksperiencat dhe njohuritë e tij gjuhësore e kulturore. PEGJ-i nxit nxënës/in të përmirësojë mësimin dhe kapacitetin e vlerësimit të aftësive të tij në fushën e gjuhëve. Përdorimi i PEGJ-it favorizon lëvizjen në Evropë duke informuar aftësitë për gjuhët në mënyrë të qartë dhe të krahasueshme në nivel ndërkombëtar. PEGJ-i kontribuon në mirëkuptimin reciprok në Evropë nëpërmjet eksperiencës së kulturave të tjera dhe me ndihmën e kapaciteteve të komunikimit në shumë gjuhë.

- Nxënësit, gjithashtu, vlerësojnë punën e njëri-tjetrit në grupe, duke marrë role të ndryshme, madje dhe pa nevojën e ndihmës së mësuesit.
- Nxënës/i,-ja mban shënim arritjet e tij/saj, duke përdorur edhe gjuhën amtare.
- Mësues/i,-ja bisedon me nxënës/in,-en individualisht dhe tregon arritjet e tij/saj.

Interesi më i madh i vetëvlerësimit qëndron në faktin se ai është faktor motivimi dhe ndërëgjegjësimi; ai i ndihmon nxënësit të njohin pikat e tyre të forta dhe

të dobëta dhe kështu, të organizojnë më mirë të nxënësit e tyre. Nga vetëvlerësimi përfiton si nxënës/i,-ja, ashtu edhe mësues/i,-ja.